



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË

Përmbledhje



E Mbledhjes së Gjashtë të Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave (KKSP)

e mbajtur nëpërmjet platformës virtuale Webex
ditën e Enjte, datë 17 Dhjetor 2020, nga ora 13:00 deri 16.30.

Në datën 17 dhjetor u zhvillua mbledhja e gjashtë e Komitetit Kombëtar i Sistemit të Pagesave (KKSP). Për shkak të kufizimeve të detyruara nga pandemia e COVID-19 kjo mbledhje u zhvillua në mënyrë virtuale në platformën Webex. Mbledhja u drejtua nga Kryetarja e këtij Komiteti, **zj. Luljeta Minxhozi, Zëvendësguvernatore e Parë e Bankës së Shqipërisë.**

Në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave, si përfaqësues nga Departamenteve të ndryshme të Bankës së Shqipërisë, Sekretari i Përgjithshëm i Shoqatës Shqiptare të Bankave dhe Kryetari i Komitetit të Pagesave pranë kësaj shoqate, përfaqësues nga Kryeministria, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), përfaqësues të institucioneve financiare jobanka dhe përfaqësues të operatorëve të skemave kombëtare të pagesave. Në mbledhje ishin të pranishëm gjithashtu edhe përfaqësues nga të gjitha bankat e sistemit.

Me qëllim përmbushjen e rolit katalizator të Komitetit, si dhe angazhimin për zgjerimin e kapaciteteve institucionale në kuadër të përmbushjes së Strategjisë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël në mbledhje ishin gjithashtu të ftuar edhe një sërë aktorësh të rëndësishëm për mbështetjen e tematikave të zhvilluara gjatë mbledhjes, ku mund të përmenden Banka Botërore dhe kompanitë SWIFT, TIETO dhe CBI S.c.p.a.

Mbledhja u hap nga Kryetarja KKSP. Në fjalën e saj hyrëse, zj. Minxhozi, falenderoi institucionet anëtare për përpjekjet dhe arritjet e vazhdueshme, si dhe të ftuarit në takim, të cilët me prezantimet e tyre do të ndihmonin në arritjen e objektivave të KKSP-së. Në vijim, zj. Minxhozi bëri një përmbledhje të arritjeve të deritanishme si dhe theksoi rëndësinë që ka marrë Strategjia Kombëtare e Pagesave me Vlerë të Vogël, si në nivel kombëtar, ashtu edhe në kuadër të integritit evropian të Shqipërisë. Kryetarja u ndal edhe në nevojën e zbatimit në praktikë të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, si një nga masat dhe arritjet kryesore të strategjisë. Gjithashtu, ajo vuri në dukje nevojën për krijim dhe përmirësim të infrastrukturave si Instant Payment dhe procesimit në vend të kartave, si dhe promovimin e edukimit financiar si një mekanizëm i rëndësishëm për arritjen e objektivave të rritjes së përfshirjes financiare të popullsisë dhe zgjerimit të përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave.

Seksioni i Parë: Realizimi i deritanishëm i planit të masave të parashikuara në strategjinë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël dhe nevojat për rishikim të disa afateve dhe objektivave

Me qëllim vijimin e përmbushjes së objektivave të përbashkëta të institucioneve pjesëmarrëse të vendosura nëpërmjet miratimit të Strategjisë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël (2018-2023) seksioni i parë i mbledhjes së gjashtë filloi me një prezantim të **zj. Ledia Bregu, Drejtore e Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës pranë Bankës së Shqipërisë** mbi arritjet e deritanishme, prioritetet në vijim si dhe nevojat për rishikim të disa afateve për masat e parashikuara me qëllim krijimin e afateve kohore të cilat mundësojnë realizimin e tyre. Këto rishikime në afate synojnë jo vetëm akomodimin e nevojave kohore për realizimin e objektivave por dhe rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së KKSP. Vlen të theksohet se, nga prezantimi i zj. Bregu u evidentua se një pjese e konsiderueshme e masave të parashikuara në planin e veprimit të strategjisë janë realizuar. Megjithatë, në periudhën e mbetur nevoja për të vijuar dhe bashkërenduar përpjekjet mbetet mjaft e rëndësishme.

Në vazhdim, dhe si një nga nismat më të rëndësishme të kësaj strategjie u diskutua dhe zbatimi i ligjit 55/2020, datë 30.04.2020 “Për shërbimet e pagesave”. Në këtë drejtim, u mbajt një prezantim nga **z. Deniz Deralla, Drejtor i Departamentit të Mbikëqyrjes pranë Bankës së Shqipërisë** në lidhje me hartimin e akteve nënligjore dhe masave të nevojshme të cilat duhet të ndërmerren nga institucionet subjekte të këtij ligji, gjatë periudhës tranzitore të implementimit të ligjit dhe të akteve nënligjore në zbatim. Në këtë drejtim z. Derralla vëmendje të veçantë i kushtoi shpjegimit të dispozitave tranzitore të ligjit 55/2020 “Për shërbimin e pagesave” dhe ndërthurjes me planin e veprimit për hartimin e akteve nënligjore.

Në vijim të seksionit, në përmbushje të rolit katalizator që ka KKSP në fushën e pagesave, prezantoi pjesëmarrësit me një sërë praktikash dhe shërbimesh të cilat do të mbështesin zbatimin e ligjit në praktikë.

Të ftuar për këtë qëllim ishin përfaqësuesit e CBI S.c.p.a të cilët u prezantuan pjesëmarrësve eksperiencën e tregut italian mbi zhvillimin e *Open banking* dhe *Application Programming Interface (API)* në zbatim të detyrimeve që u burojnë Bankave për pajtueshmërinë me Ligjin e Shërbimeve të Pagesave. Më konkretisht, **zj. Liliana Fratini Passi, Drejtore Ekzekutive e CBI S.c.p.a** theksoi rëndësinë e krijimit të infrastrukturave të centralizuara për këtë qëllim si rrjedhojë e reduktimit të kostove dhe maksimizimit të efekteve. Në vijim u mbajt edhe një prezantim nga **z. Edgars Bremze përfaqësues i kompanisë TIETO**, i cili shpjegoi eksperiencën e kompanisë tyre në tregje të ndryshme mbi zhvillimin e API të qendëruara. Ky seksion përfundoi me prezantimin e **z. Eric Weinberger, përfaqësues i SWIFT** i cili shpjegoi për aktorët e tregut shërbimet e ofruara nga kjo kompani, e cila përdoret gjerësisht nga tregu bankar shqiptar, në lidhje me nevojat për komunikim të bankave dhe jo bankave në lidhje me *Open banking* dhe *Application programming interface (API)*.

Seksioni i Dytë: Tregtia elektronike një prioritet për digjitalizimin dhe formalizmin e ekonomisë shqiptare

Në seksionin e dytë të mbledhjes, vëmendje iu kushtua nismës për zhvillimin e tregtisë elektronike në Shqipëri, ku me urdhër të Kryeministrit është ngritur Grupi i punës “Për hartimin e planit të veprimit për nxitjen e tregtisë elektronike” i cili drejtohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, njëkohësisht edhe anëtare KKSP. Nga pikëpamja e kryerjes së pagesave në tregtinë elektronike masat e parashikuara në planin e veprimit në fjalë ndërlidhen ngushtë me Strategjinë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël,

dhe si rrjedhojë bashkëpunimi dhe ndërveprimi institucional do të mbështesë ndjeshëm arritjen e objektivave të përbashkët. Në këtë kuadër u mbajt një prezantim nga zj. Arjana Dyrmishi, në lidhje me objektivat e Grupit të Punës dhe ndërlidhjen e tyre me objektivat e strategjisë kombëtare të pagesave me vlerë të vogël të KKSP. Në mbështetje të këtyre nismave të përbashkëta u mbajt prezantim nga **z. Holti Banka dhe z. Hemant Baijal, përfaqësues të Bankës Botërore** në lidhje me *Instant payments* si një nga zhvillimet infrastrukturore të nevojshme dhe të parashikuar në planet e veprimit të strategjisë së KKSP dhe Grupit të Punës për zhvillimin e tregtisë elektronike. Në këtë drejtim, përfaqësuesit e Bankës Botërore pasi shpjeguan zhvillimet në rrafshin ndërkombëtar analizuan dhe mundësitë e zbatimit të këtij projekti edhe në Shqipëri, duke prezantuar përfitimet dhe problematikat e 4 përfaqësuesve të ndryshme.

Seksioni vijoi me një prezantim të **z. Thomas Ramadan, përfaqësues i SWIFT** ku u shpjeguan elementet e nevojshëm për krijimin e infrastrukturave efikase të *Instant Payment*. Gjithashtu, z. Ramadan prezantoi eksperiencën dhe shërbimet e ofruara nga kompania në lidhje me këto shërbime të pagesave në kohe reale.

Në mbështetje të diskutimeve për kostot e pagesave me karta, të cilat vlerësohet se ndikojnë në përdorimin e gjerë të tregtisë elektronike **zj. Eneida Thomaj, Drejtuese Ekzekutive e PAYLINK** mbajti një prezantim mbi përfitueshmërinë që mund të ketë tregu shqiptar nga ekzistenca e një infrastrukture e cila proceson pagesat me kartë brenda vendit (SWITCH Kombëtar).

Seksioni i Tretë: Edukimi Financiar - Koordinimi i përpjekjeve dhe hartimin e një strategjie kombëtare

Në vijim të mbledhjes, ashtu si dhe në mbledhjen paraardhëse vëmendje iu kushtua edukimit financiar si një mekanizëm mjaft i rëndësishëm e i domosdoshëm për të maksimizuar efektet e masave të ndërmarrura në kuadër të inovacionit dhe promovimit të instrumenteve dixhitale financiare. Në këtë drejtim z. Altin Tanku, Drejtor i Departamentit të Kërkimeve të Bankës së Shqipërisë prezantoi masat dhe elementet e nevojshme për t'u ndërmarr në kuadër të krijimit të një strategjie kombëtare për edukimin financiar. Seksioni vijoi me prezantimin e **z. Niko Kotonika, Drejtor i Mbikëqyrjes së Tregjeve Kapitale dhe Fondeve të Investimit pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF)**. Në prezantimin e tij z. Kotonika shpjegoi nismat e AMF në kuadër të promovimit të inovacionit me fokus kryesor ligjin “*Për Tregjet Financiare të Bazuara në Teknologjinë e Regjistrave të Shpërndarë*” dhe nevojën për nxitjen e edukimit financiar të publikut në këtë drejtim. Seksioni përfundoi me prezantimin e **z. Spiro Brumbulli, Sekretar i Përgjithshëm të Shoqatës Shqiptare të Bankave (SHSHB)** në lidhje me nismat e Shoqatës për Edukimin Financiar. Në prezantimin e tij z. Brumbulli dha një këndvështrim afatgjatë të nismave të marra nga SHSHB në këtë drejtim duket u fokusuar më së shumti në fushatën e ndërmarrë së fundi për promovimin e përdorimit të kartave si mjet pagese. z. Brumbulli theksoi se nga analizat e bëra nga Shoqata është evidentuar se publiku i gjerë i përdor kartat me qëllim tërheqjen e parasë fizike dhe në shumë raste nuk janë të vetëdijshëm që ata mund të kryejnë pagesa në internet edhe me karta debiti.

Seksioni i Katërt: Opercionalizimi pjesëmarrjes së institucioneve financiare jobanka në sistemin AECH

Ky seksion i mbledhjes u fokusua mbi masat e ndërmarrura nga ana e Bankës së Shqipërisë në lidhje me “*Opercionalizimin e pjesëmarrjes së institucioneve financiare jo banka në sistemin AECH*” masë kjo e cila vlerësohet të mbështesë ndjeshëm ndërveprimin e aktorëve të tregut dhe në një farë mënyre të krijojë kushtet e nevojshme për të minimizuar marrëdhënien e ndërvarësisë së institucioneve financiare jobanka për anëtarësimin e tyre në sistemet e pagesave. Ky prezantim u mbajt nga **zj. Marsida Ganaj (Jubica) përfaqësuese e Departamentit të Sistemeve të Pagesave Kontabilitetit dhe Financës**. Në prezantimin e saj zj. Ganaj (Jubica) shpjegoi kërkesat rregullative dhe teknike të nevojshme për anëtarësimin në sistem.

Në lidhje me këtë çështje përtej prezantimit të mbajtur nga Banka e Shqipërisë u mbajt edhe një prezantim nga **zj. Judit Baracs përfaqësuese e kompanisë SWIFT** mbi shërbime e ofruara nga kompania në lidhje me këtë kategori pjesëmarrësish, pasi anëtarësimi i institucioneve financiare jobanka mundësohet vetëm me përdorimin e infrastrukturës SWIFT për komunikimin e pjesëmarrësve me sistemin.

Seksioni i Pestë: Masat e ndërmarra gjatë pandemisë

Në seksionin e fundit të mbledhjes **zj. Valentina Semi përfaqësuese e Departamentit të Sistemeve të Pagesave Kontabilitetit dhe Financës**, prezantoi masat e ndërmarra në lidhje me përpalljen e kufizimit të lëvizjes në kuadër të pandemisë së Covid-19 gjatë vitit 2020 dhe të cilat në mënyrë të tërthortë mbështeten dhe promovimin e përdorimit të pagesave elektronike në ekonominë shqiptare, si rishikimi i komisioneve të përballuara nga klientët dhe bankat, diferencimi i pagesave të iniciuara elektronikisht dhe atyre në letër, rekomandimet e Bankës së Shqipërisë ndaj bankave për facilitimin e përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave dhe aktivizimin e elementëve të nevojshëm për përdorimin edhe të kartave të debitit për blerje *online*, e mbi të gjitha, monitorimin nga Bankat të normës së dështimit të veprimeve me kartë e marrjen e masave për zvogëlimin e tyre. Në këtë seksion përtej prezantimit mbi masat e marra nga ana e Bankës së Shqipërisë, vëmendje e veçantë iu kushtua zhvillimeve të ndërmarra nga ana e AKSH-it gjatë kësaj periudhë dhe problematikat e hasura. Prezantimi i **zj. Nevila Repishti, Drejtoreshë Portalit Qeveritar e-Albania** informoi pjesëmarrësit mbi masat e marra me qëllim digjitalizimin e shërbimeve të qeverisë me fokus pagesat, si dhe nevojat për bashkëpunim të mëtejshëm me bankat. Vlen të theksohet se masat e marra deri tani kanë kontribuar në rritjen e konsiderueshme të flukseve të pagesave të kryera nëpërmjet e-Albania, ku gjatë vitit 2020 kanë pasqyruar një rritje prej 36% krahasuar me një vit më parë.

Në përfundim të mbledhjes, duke u bazuar në diskutimet e mbledhjes, Kryetarja e Komitetit rekomandoi krijimin e disa grupeve të punës, me qëllim marrjen e masave konkrete mbi çështjet e ngritura në mbledhje, në lidhje me edukimin financiar dhe pagesat me karta në tregun shqiptar, si nga pikëpamja e reduktimit të kostove të mbartura nga tregtarët ashtu edhe në lidhje me procesimin e tyre.

Vendimet e mbledhjes së gjashtë të Komitetit Kombëtarë të Sistemit të Pagesave

U miratua rishikimi i afateve të planeve të veprimit ende në proces apo të pa iniciuara të Strategjisë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të vogël.

Rekomandimet e mbledhjes së gjashtë të Komitetit Kombëtarë të Sistemit të Pagesave

1. Krijimi i një grupi pune ndërinstytucional me qëllim mbështetjen e punës për hartimin e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit 55/2020 “Për Shërbimet e Pagesave” ku të përfshihen bankat, jobankat, AKSHI si dhe aktorë të tjerë të interesuar.
2. Vijimi i punimeve për krijimin e një Task Force me përbërje gjithëpërfshirëse për hartimin e një Strategjie Kombëtare për Edukimin Financiar.
3. Vijimi i punës për analizimin e kostove të mbartura nga bizneset të cilat ofrojnë pagesa me kartë nëpërmjet:
 - a) Kërkesës nga ana e bankave të raportojnë pranë Bankës së Shqipërisë mbi metodologjinë e përcaktimit të këtyre komisioneve (*bazuar edhe në kërkesën e ligjit “Për shërbimet e pagesave” për komisione të bazuar në kostot e ofruesve të shërbimeve*).

- b) Të mblidhen sistematikisht të dhëna mbi tarifën e ngarkuar nga pranuesit e kartave të pagesave drejt tregtarëve dhe të përfshihen këto të dhëna në bazën e të dhënave të BSH-së mbi shërbimet bankare në forme të agreguar.
 - c) Bankave dhe në përgjithësi ofruesve të shërbimeve të pagesave që janë pranues të kartave të pagesave t'u kërkohet me rregullore të jenë transparente mbi tarifën që u ngarkojnë tregtarëve.
 - d) Të vlerësohet mundësia e transpozimit në tregun shqiptar rregullorja e Bashkimit Europian 2015/751 mbi tarifën e këmbimit (*interchange fee*) për transaksionet e pagesave të bazuara në karta.
 - e) Të analizohen kostot e procesimit të pagesave me kartë dhe të vlerësohen mundësitë e reduktimit të tyre nëpërmjet platformave kombëtare të cilat reduktojnë ciklin e procesimit e për rrjedhojë dhe kostot e mbartura".
4. Përpjekje nga ana e bankave për zgjerimin e kartave të debitit të cilat mund të kryejnë blerje në internet dhe raportimi i këtyre zhvillimeve pranë Bankës së Shqipërisë në mënyrë periodike (*me frekuencë mujore*). Ky rekomandim përtej objektivave të Strategjisë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël ndihmon dhe në përmbushjen e angazhimeve të Grupit Ndërinstitucional krijuar me Urdhër të Kryeministrit mbi hartimin e planit të veprimit për nxitjen e tregtisë elektronike.
 5. Marrja e masave nga ana e bankave për minimizimin e transaksioneve të dështuara me kartë në internet. Monitorimi nga ana e Bankës së Shqipërisë i procesit të mbikëqyrjes pranë bankave në lidhje me problematikat e hasura në procesimin e pagesave me kartë në internet.

Pjesëmarrja në mbledhje.

Të Ftuar në Mbledhjen e Gjashtë e KKSP	
Institucioni	Emri i të ftuarit
SWIFT	Zj. Judit Baracs
SWIFT	Z. Eric Weinberger
SWIFT	Z. Thomas Ramadan
CBI S.c.p.a	Zj. Liliana Fratini Passi
TIETO	Z. Edgars Bremze
Banka Botërore	Z. Holti Banka
Banka Botërore	Z. Hemant Baijal

Anëtarët e KKSP në Mbledhjen e Gjashtë			
Institucioni	Emri i Anëtarit	Statusi në KKSP	Përfaqësuar të tjerë të institucionit
Banka e Shqipërisë	Zj. Luljeta Minxhozi, <i>Zëvendësguvernatore e Parë</i>	Kryetare	
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Zj. Majlinda Demko <i>Këshilltare e Ministrit MFE</i>	Anëtar	Zj.Arjana Dyrmishi Zj.Alma Beja
Kryeministria	Zj. Florenca Haxhi	Anëtar	
Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	Zj. Nevila Repishti <i>Drejtor, e-Albania</i>	Anëtar	
Ministria e Brendshme	Zj. Elora Kokalari	Anëtar	

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare	Z. Niko Kotonika <i>Drejtor i Mbikëqyrjes së Tregjeve Kapitale dhe Fondeve të Investimit</i>	Anëtar	
Banka e Shqipërisë	Zj. Ledia Bregu, <i>Drejtor, Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës</i>	Anëtar	Zj. Marsida Ganaj (Jubica), Z. Valer Miho
Banka e Shqipërisë	Z. Deniz Deralla, <i>Drejtor, Departamenti i Mbikëqyrjes</i>	Anëtar	
Banka e Shqipërisë	Z. Altin Tanku, <i>Drejtor, Departamenti i Kërkimeve</i>	Anëtar	
Banka e Shqipërisë	Z. Donald Duraj, <i>Shefi i Kabinetit</i>	Anëtar	
Banka e Shqipëri	Z. Indrit Xhemali <i>Drejtor i Departamentit të Teknologjisë së Informacionit</i>	Anëtar	
Shoqata Shqiptare e Bankave	Z. Spiro Brumbulli <i>Sekretar i Përgjithshëm i SHSHB</i>	Sekretariat	
Shoqata Shqiptare e Bankave	Zj. Najada Xhaxha, <i>Kryetare e Komitetit të Pagesave SHSHB</i>	Anëtar	
Paylink	Zj. Eneida Thomaj, <i>Drejtor i Përgjithshëm</i>	Anëtar	Z. Irida Huta
Unioni Financiar	Z. Elton Çollaku, <i>Drejtor i Përgjithshëm</i>	Anëtar	
Easy Pay	Zj. Linda Shomo <i>Drejtor i Përgjithshëm</i>	Anëtar	Zj. Stela Shkodrani
MPay	Z. Ludovic Laventure, <i>Drejtor i Përgjithshëm</i>	Anëtar	Zj. Bora Ferri,
AK-Invest	Zj. Suzana Adili	Anëtar	Zj. Odeta Ferro, Zj. Geis Ceku
Posta Shqiptare	Z. Dritan Monka	Anëtar	Z. Taulant Piero
Banka e Shqipërisë	Zj. Valentina Semi <i>DSPKF</i>	Sekretariat	
Pjesëmarrës të Tjerë			
Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a.	Zj. Ines Vucini, Zj. Elona Labinoti, Z. Erion Maxhari, Z. Roumen Ivanov		
Banka Kombëtare Tregtare sh.a.	Z.Denis Hoxha, Z.Kerem Pamuk, Zj. Marinela Rapaj, Zj. Marseda Dumani, Zj.Xhensila Sinjari		
Banka Credins sh.a.	Z. Dimitri Toslluku, Zj. Suela Cela, Zj. Valbona Dhjaku		
Banka OTP Albania sh.a	Z. Ardian Hasa, Zj. Liljana Shkodra, Zj. Bertina Hajdini, Zj.Lorina Vangjeli, Z. Ferid Shijaku		
Banka Raiffeisen sh.a	Z. Gentian Capo, Z. Almir Zeneli, Z. Erion Serti		
Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a.	Z. Ermal Hush, Z. Adrian Guza, Z.Donald Rrapaj		
Banka Alpha Albania sh.a.	Z. Edison Koleta, Z.Erand Tarka, Z.Anisa Jazxhi		
Banka Tirana sh.a.	Zj. Eralda Tafaj		
Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a.	Zj. Rudina Lolo, Z.Sokol Pellumbi, Zj. Luçi Shiroka, Zj. Ilirjana Myrto, Zj. Xhilda Shehu		

Banka Amerikane e Investimeve sh.a.	Zj. Odeta Paloka, Znj. Brikena Hoxha, Znj. Majlinda Miho, Z. Kristi Bodeci
Banka Union s h.a.	Zj. Suela Bokshi, Zj. Valbona Cucka